



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
REKTORATI

Nr. 475/ Prot.

Tiranë, më 08.02 2023

V E N D I M

Nr. 16 dt. 08.02 2023

“PER
MIRATIMIN E NDRYSHIMEVE NE KONKURSIONIN E PRANIMIT NE FAKULTETIN E
SHKENCAVE TË LËVIZJES 2023-2024”

Mbështetur në nenin 3 paragrafi 4 pika b, nenin 40, nenin 69 pika 3, nenin 74, nenin 76 të Ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë”, nenin 7 paragrafi 4 pika b, nenin 25, 72, 74, 75 të Statutit të UST, në nenin 1, 58, 60 të Rregullores së UST, si dhe mbështetur në shkresën e Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes nr. 1851/1 Prot., datë 17.11.2022 “Përcjellje e raportit të grupit të punës për shqyrtimin e testeve të pranimit për femra e meshkuj për kohën, pikezimin dhe penalitetet për vitin akademik 2023-2024”, Rektorati në mbledhjen e datës 08.02.2023;

V E N D O S I :

1. Miratimin e ndryshimeve në testet praktike të pranimit në FSHL për vitin akademik 2023-2024:
 - Testet praktike të pranimit në Fakultetin e Shkencave të Lëvizjes për Meshkuj;
 - Testet praktike të pranimit në Fakultetin e Shkencave të Lëvizjes për Femra;

(bashkëlidhur shkresa e Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes)

2. Ky vendim t’i përcillet për miratim Senatit Akademik të UST-së.

REKTORI

Prof. Dr. AGRON KASA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
REKTORATI

Nr. 475/ Prot.
2

Tiranë, më 08.02 2023

V E N D I M

Nr. 14 dt. 08.02 2023

“PER
MIRATIMIN E KRITEREVE TE PRANIMIT 2024-2025 NE TE TRE FAKULTETET E
UNIVERSITETIT TE SPORTEVE TIRANE”

Mbështetur në nenet 3, 40, 69 pika 3, 74, 76 të Ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë”, nenet 7, 25, 72, 74, 75 të Statutit të UST, në nenet 7, 11, 58, 60 të Rregullores së UST, shkresën e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit nr. 8046 Prot. datë 09.12.2022 “Për publikimin e kriterëve të pranimit të studentëve për vitin akademik 2024-2025” si dhe mbështetur në shkresën e Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes nr. 274 Prot., datë 25.01.2023 “Kërkesë për miratimin e kriterëve të pranimit të studentëve në të gjitha programet e studimit që ofron FSHL për vitin akademik 2024-2025”, shkresën e Fakultetit të Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit nr. 449 Prot., datë 07.02.2023 “Kërkesë për miratimin e kriterëve të pranimit të studentëve në programet e studimit të ciklit të parë “Bachelor” dhe ciklit të dytë “Master Profesional” e “Master Shkencor” për vitin akademik 2024-2025” dhe shkresën e FSHR-së 449/1 Prot., datë 07.02.2023, Rektorati në mbledhjen e datës 08.02.2023.

V E N D O S I :

1. Miratimin e kriterëve të pranimit në të tre Fakultetet e Universitetit të Sporteve të Tiranës për vitin akademik 2024-2025 si vijon:

1.1 KRITERET E PRANIMIT NË FAKULTETIN E SHKENCAVE TË LËVIZJES

A. Për ciklin e parë të studimeve “Bachelor” në “Shkencat e Lëvizjes”

1. Pranohen kandidatët që kanë kryer arsimin e mesëm të përgjithshëm apo profesional dhe kur kanë kryer jo më pak se 12 vjet shkollë në ciklet parauniversitare.
2. Pranohen kandidatët që zotërojnë diplomë të shkollës së mesme jashtë vendit, por pasi të jetë bërë ekuivalentimi i diplomës së fituar në vendin e huaj nga MAS.
3. Pranimi në programin “Bachelor” është i mundur për çdo kandidat që ka përfunduar me sukses ciklin e arsimit të mesëm dhe që plotëson:

- Kriterin e meritës (mesatare e shkollës së mesme) e përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave.
- Kriteret e vendosura për konkursin e pranimit. (testet e miratuara nga Senati i UST-së dhe të shpallura në Ëeb-in zyrtar të universitetit).
- Kushtet shëndetësore sipas Kartelës Mjekësore të miratuara nga UST-ja dhe të shpallura në Web-in e UST-së.

B. Për ciklin e dytë të studimeve “Master Profesional” në “Trajner i përgatitjes fizike”

1. Në programin Master Profesional “Trajner i përgatitjes fizike” pranohen kandidatët të cilët minimalisht plotësojnë një diplomë “Bachelor” të përfituara në një nga programet e ofruara së UST-së pranë FSHL-së ose FVFR-së.
2. Gjithashtu pranohen në këtë program studimit të gjithë kandidatët që vijnë nga IAL të tjera dhe që zotërojnë diploma ekuivalente me ato të ofruara në UST sipas pikës 1.
3. Studentët që kandidojnë për këtë program studimit dhe që diploma e tyre ka përputhshmëri më të vogël se 70% e programeve të ofruara në UST, pranohen të regjistrohen në këtë program me debi kreditesh duke i plotësuar ato sipas një plani kurrikulor, të ndërtuar nga departamenti që ofron programi i studimit.
4. Renditja e kandidatëve bëhet sipas kriterit të meritës (notës mesatare) dhe diplomës paraprake të fituar në UST dhe jashtë saj.

C. Për ciklin e dytë “Master i Shkencave” në “Mësuesi në Edukimin Fizik e Shëndetësor”

1. Kanë të drejtë të konkurojnë për të ndjekur studimet në ciklin e dytë “Master i Shkencave” në “Mësuesi në Edukimin Fizik e Shëndetësor” kandidatët që kanë përfunduar me sukses studimet në programet e ciklit të parë “Bachelor” pranë FSHL^{-së}, FVFR^{-së} apo IAL^{-ve} të tjera të ngjashme me të;
2. Kriteri bazë i klasifikimit të kandidatëve do të jetë ai i notës mesatare të ponderuar të studimeve të ciklit të parë “Bachelor” si dhe kriteri i rëndësisë. Për kandidatët që kanë përfunduar studimet në programet e ciklit të parë “Bachelor” pranë FSHL^{-së}, FVFR^{-së} koeficienti është 1.4, për kandidatët që kanë përfunduar studimet në IAL^{-së} të tjera të ngjashme me të koeficienti është 1.
3. Kriter pranimi për programet e Studimit të ciklit të dytë “Master i shkencave” është njohja nga kandidatët e një prej gjuhëve të huaja të BE, (anglisht, frengjisht, gjermanisht italisht, spanjisht). Nëse kandidati ka fituar një diplomë të një programi studimi të kryer në një nga këto gjuhë, diploma e fituar shërben si dëshmi për plotësimin e këtij kriteri. Niveli i gjuhës së huaj duhet të jetë të paktën B1.
4. Kanë të drejtë të konkurojnë për të ndjekur studimet në ciklin e dytë “Master i Shkencave” në “Mësuesi në Edukimin Fizik e Shëndetësor” studentët e shkëlqyer, të cilët mund të rregjistrohen njëkohësisht në më shumë se një program studimi sipas përcaktimeve ligjore (Ligji nr.80/2015 neni 97, pika 3);

D. Për ciklin e dytë të studimeve “Master i Shkencave” në “Shkenca Sportive”

1. Kanë të drejtë të aplikojnë për programin e studimit të ciklit të dytë *Master i Shkencave në “Shkenca Sportive”*, kandidatët që:
 - a. Kanë përfunduar me sukses studimet dhe janë pajisur me diplomën përkatëse të vlefshme në Republikën e Shqipërisë, në një program të ciklit të parë në fushën përkatëse të studimit ose në fusha të tjera të përafërta, i cili rezulton i akredituar në momentin e diplomimit të studentit.
 - b. Janë diplomuar jashtë vendit në një program studimi të ciklit të parë, të akredituar. Në çdo rast pranimi kandidati duhet të ketë kryer njësimin e diplomës pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin.
2. Në studimet e ciklit të dytë Master i Shkencave në “Shkenca Sportive”, pranohen:
 - i. Pa njohuri plotësuese, studentët që zotërojnë Diplomë Universitare të ciklit të parë:
 - Diplomuar në një nga programet Bachelor të ofruara në UST.
 - “Bachelor” në “Shkencat e Lëvizjes”, “Fushat e Veprimtarisë Fizike të Shëndetit dhe të Rekreacionit”, në universitete të tjera.
 - Diplomë e Niveli të Parë në fusha të ngjashme.
 - Nga fusha të njëjta, të përafërta ose të ndërlidhura me Shkencat Sportive, ku përfshihen:
 - Diplomat e ciklit të parë të integruara
 - Master në Shkencat Mjekësore
 - ii. Me plotësim të njohurive,
Studentët që zotërojnë Diplomë Universitare të ciklit të parë:
 - “Bachelor” ose Diplomë e Niveli të Parë nga fusha të tjera dhe që kanë interesa në studim të Shkencave Sportive pranohen në plotësim të njohurive në disiplinat e Mjekësisë Sportive (Fiziologji, Anatomji, Biologji dhe Biomekanikë).
3. Kriter pranimi në një program studimi të ciklit të dytë “Master i shkencave” është njohja nga kandidati e një prej pesë gjuhëve të huaja të Bashkimit Evropian: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht në përputhje me udhëzimin e ministrisë përkatëse për arsimin, ku përcaktohet dhe tipi i çertifikatës së fituar. Nëse individi ka fituar një diplomë të një programi studimi të kryer në një nga këto gjuhë, diploma e fituar shërben si dëshmi për plotësimin e këtij kriteri.
4. Në varësi të kërkesave dhe kuotave të përcaktuara nga institucionet përgjegjëse, përparësi do të kenë studentët që kanë përfunduar drejtime studimi ekuivalente, brenda dhe jashtë shtetit, si dhe notë mesatare më të lartë. Ky kriter do të jetë i rivlerësueshëm çdo vit akademik, në varësi të studentëve konkurrues.

E. Për ciklin e tretë të studimeve “Doktoratë” në “Shkenca Sportive”

- Kanë të drejtë të kandidojnë për të ndjekur studimet në ciklin e tretë “Doktoratë” kandidatët që kanë diplomë universitare “Master i Shkencave” në UST;

- Kanë të drejtë të kandidojnë për të ndjekur studimet në ciklin e tretë “Doktoratë” kandidatët që kanë diplomë të sistemit të vjetër 4-vjeçar në UST;
- Kanë të drejtë të kandidojnë për të ndjekur studimet në ciklin e tretë “Doktoratë” kandidatët që kanë diplomë “Master i Shkencave” ose DND, të fituara në institucione të tjera të arsimit të lartë, brënda ose jashtë vendit, në përputhje me përcaktimet e bëra në programin e studimeve të doktoraturës ose në rregulloren e saj;
- Kandidatët duhet të kenë mesatare të ponderuar të notave në ciklin e parë të studimeve (diploma Bachelor/DND) dhe në ciklin e dytë të studimeve Master i Shkencave/DND, të programeve të integruara të nivelit të dytë dhe të sistemit të vjetër 4-vjeçar, jo më të vogël se 8 (tetë), ose jo më pak se 80% e pikëve totale;
- Kandidatët duhet të jenë njohës të njërës prej gjuhëve të huaja si: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht, të vërtetuar përmes testeve të njohura ndërkombëtare në nivelin e miratuar nga SA i UST, në përputhje me kornizën ligjore në fuqi;
- Kandidatët të cilët kanë fituar një diplomë të një programi studimi të kryer në një nga pesë gjuhët e përmendura më sipër, diploma e fituar i shërben si dëshmi për plotësimin e kriterit të gjuhës së huaj;
- Për kandidatët që kanë fituar diplomat jashtë vendit duhet të ekuivalentohen përpara aplikimit, sipas akteve ligjore në fuqi të ministrisë përgjegjëse për arsimin;
- Vetëm kandidatët të cilët plotësojnë të gjitha kriteret e mësipërme, kualifikohen për fazën tjetër të vlerësimit.

1.2 KRITERET E PRANIMIT NË FAKULTETIN E VEPRIMTARISË FIZIKE DHE REKREACIONIT

A. Për ciklin e parë të studimeve Bachelor në “Fushat e Veprimtarisë Fizike të Shëndetit dhe të Rekreacionit”

1. Kanë të drejtë të pranohen në programin e studimit të ciklit të parë Bachelor në “Fushat e Veprimtarisë Fizike të Shëndetit dhe të Rekreacionit” të gjithë kandidatët që kanë përfunduar me sukses arsimin e mesëm (Maturën Shtetërore në RSH), ose ekuivalentin e saj për shtetasit që kanë studiuar në vende të tjera.
2. Kandidatët i nënshtrohen konkurimit praktik konform testeve të miratuara nga Senati Akademik i UST dhe të shpallura në faqen web të UST.
3. Raporti ndërmjet konkurimit praktik dhe mesatares së kandidatit të jetë 70% me 30%. Për kandidatët që konkurojnë për të hyrë në ciklin e parë “Bachelor”, duhet që të grumbullojnë minimumi 10 (dhjetë) pikë nga 70 (shtatëdhjetë) të mundshme të konkurimit praktik.
4. Kandidatët që konkurojnë në këtë program studimi, duhet të plotësojnë kushtet shëndetësore sipas Kartelës Mjeksore miratuar nga UST dhe e shpallur në faqen web të saj.

B. Për ciklin e dytë të studimeve Master Profesional “Aktiviteti Fizik dhe Rekreacioni – Trajner Fitnesi”

1. Kanë të drejtë të konkurojnë për të ndjekur studimet në programin e ciklit të dytë të studimeve Master Profesional “*Aktiviteti Fizik dhe Rekreacioni – Trajner Fitnessi*” të gjithë kandidatët që kanë përfunduar me sukses studimet në ciklin e parë “Bachelor” pranë Fakultetit të Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit apo IAL të tjera të ngjashme me të.
2. Konkurimi do të bëhet mbi bazën e dosjeve personale të paraqitura nga kandidatët pranë Sekretarisë Mësimore Digjitale në UST, konform afateve të shpallura në faqen web të UST.
3. Klasifikimi dhe përzgjedhja e kandidatëve bëhet mbi bazën e kriterëve të përcaktuara në Rregulloren e programit të studimit e cila gjendet në faqen zyrtare të UST-së.

C. Për ciklin e dytë të studimeve Master Profesional “Menaxhim në Sport dhe Turizëm”

1. Kanë të drejtë të konkurojnë për të ndjekur studimet në programin e ciklit të dytë Master në “*Menaxhim në Sport dhe Turizëm*”, të gjithë kandidatët që kanë përfunduar me sukses studimet në ciklin e parë Bachelor.
2. Konkurimi do të bëhet mbi bazën e dosjeve personale të paraqitura nga kandidatët pranë Sekretarisë Mësimore Digjitale në UST, konform afateve të shpallura në faqen web të UST.
3. Kriteri bazë i klasifikimit të kandidatëve, do të jetë ai i formimit në ciklin e parë të studimeve dhe ai i notës mesatare më të lartë.

D. Për ciklin e dytë të studimeve Master Shkencor “Aktiviteti Fizik dhe Shëndeti”

1. Kanë të drejtë të konkurojnë për të ndjekur studimet në programin e ciklit të dytë Master Shkencor “*Aktiviteti Fizik dhe Shëndeti*”, të gjithë kandidatët që kanë përfunduar me sukses studimet në ciklin e parë “Bachelor” pranë Fakultetit të Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit apo IAL të tjera të ngjashme me të.
2. Konkurimi do të bëhet mbi bazën e dosjeve personale të paraqitura nga kandidatët pranë Sekretarisë Mësimore Digjitale në UST, konform afateve të shpallura në faqen web të UST.
3. Kriteri bazë i klasifikimit të kandidatëve, do të jetë ai i notës mesatare më të lartë.
4. Kanë preferencë fillimisht kandidatët që kanë përfunduar ciklin e parë “Bachelor” në sistemin me kohë të plotë dhe part time të Fakultetit të Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit.
5. Në rastet kur rezultojnë vende të mbetura bosh, do të merren në konsideratë kërkesat e paraqitura nga kandidatët që kanë përfunduar me sukses ciklin e parë “Bachelor” në IAL të tjera të ngjashme brenda dhe jashtë vendit. Edhe për këtë kategori, klasifikimi do të bëhet mbi bazën e notës mesatare më të lartë.
6. Do të pranohen kandidatët të cilët kanë të mbrojtur një nga gjuhët e huaja në programet e njohura nga MAS.

F. Për ciklin e tretë të studimeve “Doktoratë” në “Aktiviteti Fizik dhe Shëndeti”

- Kanë të drejtë të kandidojnë për të ndjekur studimet në ciklin e tretë “Doktoratë” kandidatët që kanë diplomë universitare “Master i Shkencave” në UST;
- Kanë të drejtë të kandidojnë për të ndjekur studimet në ciklin e tretë “Doktoratë” kandidatët që kanë diplomë të sistemit të vjetër 4-vjeçar në UST;

- Kanë të drejtë të kandidojnë për të ndjekur studimet në ciklin e tretë “Doktoratë” kandidatët që kanë diplomë “Master i Shkencave” ose DND, të fituara në institucione të tjera të arsimit të lartë, brënda ose jashtë vendit, në përputhje me përcaktimet e bëra në programin e studimeve të doktoraturës ose në rregulloren e saj;
- Kandidatët duhet të kenë mesatare të ponderuar të notave në ciklin e parë të studimeve (diploma Bachelor/DND) dhe në ciklin e dytë të studimeve Master i Shkencave/DND, të programeve të integruara të nivelit të dytë dhe të sistemit të vjetër 4-vjeçar, jo më të vogël se 8 (tetë), ose jo më pak se 80% e pikëve totale;
- Kandidatët duhet të jenë njohës të njëjës prej gjuhëve të huaja si: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht, të vërtetuar përmes testeve të njohura ndërkombëtare në nivelin e miratuar nga SA i UST, në përputhje me kornizën ligjore në fuqi;
- Kandidatët të cilët kanë fituar një diplomë të një programi studimi të kryer në një nga pesë gjuhët e përmendura më sipër, diploma e fituar i shërben si dëshmi për plotësimin e kriterit të gjuhës së huaj;
- Për kandidatët që kanë fituar diplomat jashtë vendit duhet të ekuivalentohen përpara aplikimit, sipas akteve ligjore në fuqi të ministrisë përgjegjëse për arsimin;
- Vetëm kandidatët të cilët plotësojnë të gjitha kriteret e mësipërme, kualifikohen për fazën tjetër të vlerësimit.

1.3 KRITERET E PRANIMIT NË FAKULTETIN E SHKENCAVE TË REHABILITIMIT.

A- Për ciklin e parë të studimeve “BACHELOR” në “Shkencat e Rehabilitimit”

1. Pranohen kandidatët që kanë kryer arsimin e mesëm të përgjithshëm apo profesional dhe kur kanë kryer jo më pak se 12 vjet shkollë në ciklet parauniversitare.
2. Pranohen kandidatët që zotërojnë diplomë të shkollës së mesme jashtë vendit të ekuivalentuar nga MAS.
3. Pranimi në programin “Bachelor” është i mundur për çdo kandidat që ka përfunduar me sukses ciklin e arsimit të mesëm dhe që plotëson:
4. Kriterin e meritës (mesatare e shkollës së mesme) e përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave.

B- Për ciklin e dytë të studimeve “MASTER PROFESIONAL” në “Rehabilitimi Fizioterapeutik në Sport”

- Në programin Master Profesional “Rehabilitimi Fizioterapeutik në Sport” pranohen kandidatët të cilët minimalisht plotësojnë një diplomë “ Bachelor” të përfituar brënda ose jashtë vendit të konvertuara nga MAS, në programet e studimit të ciklit të parë, në fusha të njëjta ose të ngjashme me ciklin e parë të studimit Bachelor në “Shkencat e Rehabilitimit”
- Gjithashtu pranohen në këtë program studimit të gjithë kandidatët që vijnë nga IAL të tjera dhe që zotërojnë diploma ekuivalente me ato të ofruara në UST sipas pikës 1.
- Studentët që kandidojnë për këtë program studimi, diploma e të cileve ka ngjashmei me programet bachelor të FSHR, pranohen të regjistrohen në këtë program me debi kreditesh duke i plotësuar ato sipas një plani kurrikulor, të ndërtuar nga departamenti që ofron programi i studimit.
- Renditja e kandidatëve bëhet sipas kriterit të meritës (notës mesatare) dhe diplomës paraprake të fituar në UST dhe jashtë saj.

2. Ky vendim t’i përcillet për miratim Senatit Akademik të UST-së.

REKTORI
Prof. Dr. AGRON KASA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
REKTORATI

Nr. 475/3 Prot.

Tiranë, më 08.02 2023

V E N D I M

Nr. 18 dt. 08.02 2023

**“PËR
MIRATIMIN E NDRYSHIMEVE NË RREGULLORET E PROGRAMEVE TË
STUDIMIT QË OFRON FAKULTETI I SHKENCAVE TË LËVIZJES”**

Mbështetur në nenin 3 paragrafi 2, pika b, nenin 33 paragrafi 3, nenin 40 të Ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 7 paragrafi 2 pika b dhe 25 të Statutit të UST-së, në nenin 11 të Rregullores së UST-së, në Vendimin e Senatit nr.109, datë 22.07.2021 “Për miratimin e riemërimit dhe riorganizimit të njësisive bazë të FSHL”, të Udhëzimit të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit nr.29 datë 07.10.2022 “Për frekuentimin e procesit mësimor sipas llojit të veprimtarive mësimore në auditor dhe ciklit të studimit” si dhe mbështetur në shkresën e Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes nr.262 prot., datë 24.01.2023 “Përcjellje e Draft-rregulloreve të programeve të studimit që ofron FSHL” si dhe në shkresën e Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes nr. 339/2 Prot., datë 03.02.2023 “Përcjellje relacioneve mbi ndryshimet në Rregulloret e departamenteve dhe Rregulloreve të programeve të studimit që ofron FSHL”, Rektorati në mbledhjen e datës 08.02.2023.

V E N D O S I :

1. Miratimin e ndryshimeve në këto Rregullore:
 - Rregullore e Programit të Ciklit të Parë të Studimeve “Bachelor” në “Shkencat e Lëvizjes”;
 - Rregullore e Programit të Ciklit të dytë të Studimeve “Master Profesional” në “Trajner i Përgatitjes Fizike”;
 - Rregullore e Programit të Ciklit të dytë të Studimeve “Master i Shkencave” në “Mësuesi në Edukimin Fizik e Shëndetësor”;
 - Rregullore e Programit të Ciklit të Dytë të Studimeve “Master i Shkencave” në “Shkenca Sportive”;
2. Ky vendim t’i përcillet për miratim Senatit Akademik të UST-së.

REKTORI

Prof. Dr. AGRON KASA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
REKTORATI

Nr. 475/4 Prot.

Tiranë, më 08.02 2023

V E N D I M

Nr. 19 dt. 08.02 2023

“PËR
KORIGJIMIN DIGJITAL TË PROVIMEVE ME SISTEMIN CLEANSCORE”

Mbështetur në nenin 2, nenin 40 të Ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 7 paragrafi 5 dhe nenin 25 të Statutit të UST-së, në nenin 11 të Rregullores së UST-së, në marrëveshjen e bashkëpunimit nr. 59 Prot. datë 14.01.2022 lidhur ndërmjet Albanian- American Development Foundation (Fondacioni Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim) dhe Universitetit të Sporteve të Tiranës “Për zbatimin e projektit CleanScore, Cilësia e materialeve mësimore dhe vlerësimi i performancës së studentëve”, shkresës së Fakultetit të Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit nr. 904/1 Prot. datë 07.06.2022 “Modulet që do të përdorin programin CleanScore në FVFR” dhe shkresës nr. 904 Prot. datë 06.06.2022 “Propozim për modulet pilot që do korrigjohen nëpërmjet programit CleanScore në FSHL”, Rektorati në mbledhjen e datës 08.02.2023

V E N D O S I :

1. Miratimin e korrigjimit digjital të provimeve me sistemin CleanScore nga muaji mars 2023 e në vijim.
2. Ky vendim t’i përcillet për miratim Senatit Akademik të UST-së.

REKTORI

Prof. Dr. AGRON KASA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
REKTORATI

Nr. 4921 Prot.

Tiranë, më 10.02 2023

V E N D I M


Nr. 20 dt. 10.02 2023

**“PËR
MIRATIMIN E RREGULLORES PËR ORGANIZIMIN E PROGRAMEVE TË
STUDIMIT TË CIKLIT TË TRETË “DOKTORATË” NË UNIVERSITETIN E
SPORTEVE TË TIRANËS”**

Mbështetur në nenet 33 paragrafi 3, 40 të Ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 4, 25, 76 të Statutit të UST-së, në nenin 11 të Rregullores së UST-së, si dhe mbështetur në shkresën nr.2002/3 datë 09.02.2023 të Grupit të Punës “Draft Rregullore e organizimit të programeve të studimit të ciklit të tretë “Doktoratë”, Rektorati në datën 10.02.2023.

V E N D O S I :

1. Miratimin e Rregullores së re për organizimin e programeve të studimit të ciklit të tretë “Doktoratë” në Universitetin e Sporteve të Tiranës.
2. Ky vendim t’i përcillet për miratim Senatit Akademik të UST-së.


REKTORI
Prof. Dr. Agron KASA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
REKTORATI

Nr. 578/1 Prot.

Tiranë, më 15.02.2023

VENDIM

Nr. 21, datë 15.02.2023

PËR

**PROPOZIMIN E NËNSHKRIMIT TË MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT
ME UNIVERSITETIN "G.D'ANNUNZIO", CHIETI-PESCARA, ITALI**

Mbështetur në Ligjin nr. 80/2015 'Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë', në nenin 25 të Statutit të UST-së si dhe në vijim të procesit të ndërkombëtarizimit të Universitetit të Sporteve të Tiranës, Rektorati në mbledhjen e datës **15/02/2023**,

VENDOSI :


1. Propozimin për nënshkrimin e marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Universitetit të Sporteve të Tiranës dhe Universitetit "G.D'Annunzio", Chieti-Pescara, Itali.
2. Ky vendim i përcillet për miratim Senatit Akademik të UST-së.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

REKTORI

Prof. Dr. Agron KASA

Konceptoi: Msc. Safiola Carcani
Numri i kopjeve origjinale : 3 (tre)





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
REKTORATI

Nr. 578/3 Prot.

Tiranë, më 15.02.2023

VENDIM

Nr. 23 datë 15.02 2023

PËR

**PROPOZIMIN E PJESËMARRJES SË UST SI BASHKËORGANIZATOR
NË KONFERENCËN E 8-TË NDËRKOMBËTARE BALLKANIKE
TË SHKENCAVE SPORTIVE ME FAKULTETIN E KULTURËS FIZIKE,
UNIVERSITETI I TETOVËS, REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT**

Mbështetur në Ligjin Nr.80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në RSH", në nenin 86, pika 1 të Statutit të Universitetit të Sporteve të Tiranës si dhe në vijim të ftesës Të dërguar nga Universiteti i Tetovës, Rektorati në mbledhjen e tij të datës **15/02/2023**,

VENDOSI:

1. Propozimin e pjesëmarrjes së Universitetit të Sporteve të Tiranës si bashkëorganizator në *Konferencën e 8-të Ndërkombëtare Ballkanike të Shkencave Sportive me Fakultetin e Kulturës Fizike, Universiteti i Tetovës*, e cila do të organizohet nga data *17-19 Maj në Tetovë, Republika e Maqedonisë së Veriut*.
2. Ky vendim i përcillet për miratim Senatit Akademik të UST-së.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

REKTORI

Prof. Dr. Agron KASA



Konceptoi: Msc. Safiola Çarçani
Numri i kopjeve origjinale: 3(tre)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
REKTORATI

Nr. 578/4 Prot.

Tiranë, më 15.02 .2023

VENDIM
Nr. 24 , datë 15.02 .2023
PËR
PROPOZIMIN E NËNSHKRIMIT TË MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT
ME UNIVERSITETIN LUARASI

Mbështetur në Ligjin nr. 80/2015 ‘Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë’, në nenin 25 të Statutit të UST-së si dhe në vijim të procesit të ndërkombëtarizimit të Universitetit të Sporteve të Tiranës, Rektorati në mbledhjen e datës **15/02/2023**,


VENDOSI :

1. Propozimin për nënshkrimin e marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Universitetit të Sporteve të Tiranës dhe LUARASI.
2. Ky vendim i përcillet për miratim Senatit Akademik të UST-së.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

REKTORI

Prof. Dr. Agron KAS



Konceptoi: Msc. Safiola Çarçani
Numri i kopjeve origjinale: 3 (tre)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
REKTORATI

Nr. 589 Prot.

Tiranë, më 16.02, 2023.

V E N D I M

Nr. 25 dt. 15.02, 2023

“PËR

**MIRATIMIN E PROPOZIMIT TË OBJEKTIVAVE
NË UNIVERSITETIN E SPORTEVE TË TIRANËS
PËR VITIN 2023”**

Në mbështetje dhe në zbatim të nenit 40, të Ligjit nr. 80/2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë”, nenit 25, të Statutit të UST, Rektorati në mbledhjen e tij të datës 15.02.2023,

V E N D O S I :

1. Të miratojë propozimin për objektivat në Universitetin e Sporteve të Tiranës, për vitin 2023, sipas tabelave bashkëngjitur.
2. Ky vendim i përcillet për miratim Senatit Akademik të Universitetit të Sporteve të Tiranës.

REKTORI

PROF. DR. AGRON KASA

